



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Himarë, më 22 . 07 . 2021

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike E-mail.

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 16.07.2021 ardhur me postë elektronike , ku kërkohet informacion lidhur sesi bëhet trajtimi i ujërave të zeza pranë Bashkisë Himarë.

- 1) Si bëhet trajtiti i ujrave të zeza në Bashkinë Himarë?
- 2)A ka Himara impiant për trajtimine ujrave të zeza? Prej sa vitesh?
- 3)A ka pika në bregdetin e Himarës ku vazhdojnë të derdhen ujra të zeza?
- 4)Ku i shkarkojnë bizneset/hotelet/banesat ujrat e zeza?

në mbështetje të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit” , bashkëngjitur do të gjeni infomacionin e kërkuar.

Faleminderit për mirëkuptimin!



UJI ËSHTË JETA !

**BASHKIA HIMARË
UJËSJELLËS KANALIZIME HIMARË SH.A**

Adresa: BashkiaHimarë Spile-Himarë.

email: ujesjellesi.himare@gmail.com

Informacion paraprak mbi rrjetin e kanalizimeve në Bashkinë Himarë

Në Bashkinë Himarë shërbimi i kanalizimeve mbulohet pjesërisht. Zonat rurale që kanë lidhje me rrjetin e kanalizimeve janë:

Zonat rurale	Nr i lidhjeve
Shën Vasil	15
Lukovë	71
Piqeras	21
Borsh	3
Qazim Pal	105
Qeparo	3
Vuno	204
Green coast Palase	302

Qyteti i Himarës ka 1500 lidhje me kanalizimet. Gjatësia totale e rrjetit të kanalizimeve është 21 km. Në qytet kemi 3 stacione pompimi të ujërave të ndotura të cilat i pompojnë drejt vaskave të dekantimit ku bëhët dhe trajtimi i tyre.

Përshkrimi i detajuar i informacionit të kërkuar

1.Trajtimi i ujërave të ndotura në qytetin e Himarës bëhet nëpërmjet vaskave të dekantimit që kanë funksionin e dekantimit të lëndës së ngurtë dhe trajtimin anaerobik. Pjesa që nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimeve funksionon me gropa septike personale . Ujësjiellësi Himarë ka gjithashtu një kontratë me një kompani pastrimi për rrjetin e kanalizimeve dhe pusetave të ujërave të ndotura.

2.Aktualisht në Himarë është një impiant i trajtimit të ujërave të ndotura në zonën Palasë që përfshin fshatrat turistik. Bashkia Himarë është pjesë dhe përfiton nga Programi I Ujësjiellësive Rurale IV i financuar nga KFW dhe WBIF ku në lotin 3 parashtrohet:



UJI ËSHTË JETA !

**BASHKIA HIMARË
UJËSJELLËS KANALIZIME HIMARË SH.A**

Adresa: BashkiaHimarë Spile-Himarë.

email: ujesjellesi.himare@gmail.com

- Rehabilitimi dhe shtrirja e sistemit të KUN Himarë
- Ndërtimi i impiantit me trajtim mekanik biologjik
- Shkarkuesit në det pas trajtimit

3. Në qytetin e Himarës kemi një pikë shkarkimi të ujërave pas trajtimit mekanik nga vaskat e dekantimit .Ndërsa sistemet me gropa septike e shkarkojnë një pjesë të lëndës së lëngshme të ujërave të ndotura në zonën përreth ose shkarkohen drejt e në kanale të hapura(në zonat rurale).

4.Bizneset,hotelet dhe banesat që janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve trajtohen nëpërmjet vaskave të dekantimit kurse pjesa tjetër ka gropa septike personale dhe pastrimi i tyre bëhet individual.